



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1818 Prot.

Roskovec, më 01, 03 2022

VENDIM

NR 10 .DATË 28 .02 .2022

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN JANAR 2022”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 27.01.2022, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Janar 2022.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: [www.bashkiaroskovec.gov.al](http://www.bashkiaroskovec.gov.al)

Nr. 668/1 Prot.

Roskovec, më 28.01.2022

Procesverbal Nr.1

*-I mbajtur sot, date 27.01.2022, ora 14, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Dhjetor 2021.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2021.
5. Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2022.
6. Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2022.
7. Për anulim të Vendimit Nr.102 datë 24.12.2021 “Për një shtesë në Vendimin Nr.93 datë 25.11.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2022”.
8. Për anulim të Vendimit Nr.107 datë 24.12.2021 “Për miratimin e programit 5 vjecar të strehimit”.
9. Për miratimin e programit 5 vjecar të strehimit .
10. Për miratim shpenzimesh nga të ardhurat të trashëguara nga viti 2021.
11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 14<sup>00</sup>

Keshilltaret prezent: A.Kola, E.Çepele, Rr.Hazizi, L.Hoxha, L.Goga, B.Kuka, K.Hyska, G.Hoxha, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, A.Sheme, H.Beqiraj, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : V.Mata, B.Çobo, T.Kuka, D.Hoxha, B.Toska.

Prezent nga bashkia: Nenkryetari M.Goga, Dr.Ekonomise, Dr.Ardhurave Vendore, P/Dr.Juridike, P/Z/Ndihmes Ekonomike.

Me plotesimin e kuorumit , kryetari hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 14 keshilltare. Para se te filloje me rendin e dites, kryetari ben me dije se kemi nje projekt-vendim shtese “Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.79 date 30.09.2021 “Per dhenien me qera te tokes se pafrytshme nr.pasurie 198/28 ne pronesi te Bashkise Roskovec”. Si dhe sakesimin e titullit te projektit te pikes Nr.10 e cila do te jete “Per nje shtese ne buxhetin e vitit 2022”. E hedh ne votim

projekt-vendimin si me siper per ta shtuar ne rendin e dites dhe sakesimin e titullit te pikes Nr.10 dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro shtesa dhe ndryshimi ne rendin e dites.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites bashke me shtesen dhe ndryshimin si me siper dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

2.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Dhjetor 2021.

Informacioni ka te bej me vendimet e miratuara nga keshilli mbledhjen e kaluar,miratimi i akteve normative nga Prefektura si dhe vendimet qe nuk jane miratuar.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Dhjetor 2021.

Elis Apostoli P/sherbimit social sqaron projektin sipas materjalit.Ve ne dukje se ka hyr ne fuqi vendimi per rritje dhe sqaron kategorite se kush perfiton nga kjo rritje.Hidhet ne votim projekti i 6% per muajin Dhjetor 2021 dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

5.Per miratimin e kriterëve per familjet ne nevoje qe do te trajtohen me ndihme ekonomike,nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per bllok-ndihmen per vitin 2022.

Elis Apostoli sqaron projektin dhe kriteret ne te cilat do te shqyrtohen familjet qe do te trajtohen nga fondi i kushtezuar 6% per vitin 2022.Sqaron kriteret sipas radhes dhe materjalit te paraqitur.Aleksander-sme duket e drejte pse keto familje nuk jane perfituese nga sistemi i pikezimit,si ka mundesi me keto kriterë dhe mos te jene fitues?Elisi sqaron se sistemi i pikezimit eshte ne sistem, se vendosim ne.Nenkryetari M.Goga jep sqarime per kete pyetje.Leksi-e kemi diskutuar disa here sistemin e pikezimit,tek keto kriterë qe ne i miratojme,keta duhet te plotesojne nje nga keto kriterë apo te gjitha keto bashke?Elisi-mjafton te plotesojne edhe nje.Leksi-sbesoj te jene vetem 6 familje qe plotesojne keto kriterë,sa vjen fondi per 6%?Elisi sqaron se fondi eshte ne varesi te familjeve perfituese ne muaj dhe fondit te tyre.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

6.Per miratimin e planit vjetor te aktivitetëve te Keshillit Bashkiak Roskovec per vitin 2022.

Sekretarja e keshillit sqaron projektin.Projekti ka te bej me planin e aktivitetëve te keshillit per vitin 2022 sipas rregullores se keshillit.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

7.Per anulim te Vendimit Nr.102 date 24.12.2021 “Per nje shtese ne Vendimin Nr.93 date 25.11.2021 “Per miratimin e paketes fiskale per vitin 2022”.

Dr.Ardhurave Vendore sqaron arsyet se perse nuk eshte miratuar nga Prefektura ky vendim.Tarifa e percaktuar nga ne ishte per rehabilitimin e mjedisit si tarife e perkohshme.Ne do e rishikojme edhe njehere nga e para duke iu permbajtur edhe konstatimeve te Prefektures,per tju sjelle nje materjal tjetër.Elmazi-del qe Prefektura ka pasur te drejte,here tjetër mos na i sillni me ashtu.Leksi-Prefektura e rrezon vetem ne baze te nje ligji duke i dhene kete te drejte Agjencis Kombetare te Mjedisit.Kjo takse do te jete ne sherbim te komunitetit se kuptoj pse duhet ta kthej Prefektura?Ditmira-ka te bej me nje term te perdorur,ne per te qene me korrekt do e rishikojme edhe njehere nga ana jone.Elmazi-une bie dakort me konfirmimet e Prefektures,nuk duhet te gabojme me vendimet.Aleksander-ne do e anulojme,por ata te Prefektures kane te drejte.Sekretarja e keshillit sqaron se procedura jone ligjore eshte ta anulojme kete vendim,sepse Prefektura nuk e ka miratuar.Hidhet ne votim anulimi i vendimit Nr.102 date 24.12.2021 “Per nje shtese ne

vendimin Nr.93 date 25.11.2021 “Per miratimin e paketes fiskale per vitin 2022” dhe miratohet unanimsisht me 14 vota pro.

8.Per anulim te Vendimit Nr.107 date 24.12.2021 “Per miratimin e programit 5 vjecar te strehimit”.

Sekretarja e keshillit sqaron se ky vendim eshte kthyer nga Prefektura per shkak se nuk i kishim realizuar degjesat publike sic duhej.Procedura ligjore eshte se duhet ta anulojme kete vendim sepse e ka kthyer Prefektura.Hidhet ne votim anulimi i Vendimit Nr.107 date 24.12.2021 dhe miratohet unanimsisht me 14 vota pro.

9.Miratimi i programit 5 vjecar te strehimit.

Behet me dije se per kete projekt u realizuan edhe njehere dy degjesa publike.Hidhet ne votim programi 5 vjecar i strehimit dhe miratohet unanimsisht me 14 vota pro.

10.Per nje shtese ne buxhetin e vitit 2022.

Dr.Finances sqaron projektin.Ato fonde qe nuk jane perdorur nga bashkia dhe ndermarrjet i kemi parashikuar per shlyerje te detyrimeve nga kontratat per sherbime dhe mallra ndaj te treteve per 2021 per bashkine dhe 2 ndermarrjet vartese si njesi shpenzuese dhe per rishikimin e planit vendor te menaxhimit te mbetjeve urbane dhe hartimin e raportit te vlersimit strategjik mjedisor.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimsisht me 14 vota pro.

11.Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.79 date 30.09.2021 “Per dhenien me qera te tokes se pafrytshme nr.pasurie 198/28 ne pronesi te Bashkise Roskovec.

P/Dr.Juridike Drinalda Fejzulla sqaron ndryshimin e vendimit Nr.79.Ka ndryshim vetem tek pika 3 e vendimit,tek afati i dhenies me qera,nga 1 vit me te drejte perseritje,e kemi sjelle me ndryshimin e afatit te qerases deri ne 20 vjet.Nenkryetari M.Goga sqaron.Nuk ka diskutime.Hidhet ne votim ndryshimi i Vendimit nr.79 date 30.09.2021 sipas materjalit dhe miratohet unanimsisht me 14 vota pro.

12.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Nuk ka diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**

**Kryetar**

**Kadri Hyska**